



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
KUADRIT RREGULLATOR**

Nr. 13584 Prot.

Tiranë, më 05.11.2018

Lënda: Njoftim për fillimin e procesit të konsultimit publik për projektligjin “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike”.

OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

**Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr. 88, H. 1, Njësia Administrative nr. 7,
1023, Tiranë**

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

**Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9, Yzberisht, Kashar,
Tiranë**

KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

**Adresa: Blloku “Vasil Shanto”,
Tiranë**

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARTIZIMIT

**Adresa: Rruga “Mine Peza”, nr. 143/3, Kutia Postare 98,
Tiranë**

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT

**Adresa: Rr “Sami Frashëri”, nr. 33, kati i I-rë,
Tiranë**

INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

**Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, nr. 56,
Tiranë**

INSPEKTORATIT QENDROR

**Adresa: Rruga “Frosina Plaku”, nr. 58,
Tiranë**

NOA CONTROL SH.P.K.

Adresa: Rruga “Nikolla Tupe”, Ndërtesa nr. 4, Kati I,

ISEI SH.P.K.

**Adresa: Rruga "Haxhi H. Dalliu", nr. 5/1, Njësia Administrative nr. 9,
Tiranë**

"SWISS APPROVAL ALBANIA" sh.p.k.

**Rruga Sami Frashëri, Ndërtesa 19, Hyrja Nr.08, 1019
Tiranë.**

TECH-INSPECT SH.P.K.

**Adresa: Rruga "Besnik Sykja", Pall 30, Hyrja 2, Ap. 12, Njësia Bashkiake nr. 2,
Tiranë**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka iniciuar përgatitjen e projektligjit "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike" dhe në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", do të organizojë konsultimin publik me Organet Publike dhe Grupet e Interesit në lidhje me këtë projektligj.

Arsyet kryesore të nevojshme për nxjerrjen e këtij projektligji janë:

- Ligji në fuqi nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", megjithë ndryshimet e pësura ndër vite, nuk i përshtatet më nevojave të stadi aktual, lidhur me sigurinë e punës së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, duke patur parasysh edhe zhvillimet teknike dhe teknologjike të ndodhura prej kësaj kohe.
- Ligji 8734 nuk parashikon detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë që përdorin, mirëmbajnë dhe/ose projektojnë pajisje, impiante e instalime elektrike, si dhe nuk parashikon kryerjen e vlerësimit të konformitetit të tyre nga "palë të treta", Organizma të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), në fushën e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike.
- Në këto kushte, nga ana e MIE është vlerësuar hartimi i projektligjit "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike", me anë të së cilit do të eliminohen problemet e mësipërme, si dhe do të realizohet një koherencë edhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin, si dhe ligjin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Qëllimi i projektligjit:

- Qëllimi i këtij projektligji është realizimi i rolit rregullator të shtetit në fushën e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike. Duke pasur në konsideratë që shteti ka detyrimin të garantojë siguri për jetën e njerëzve, të kafshëve, mjedisit dhe pronës në tërësi ky projektligj synon të përcaktojë detyrimet e operatorëve ekonomik që kryejnë aktivitete që përfshijnë prodhimin, montimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike, detyrimet të drejtat dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse (inspektoratit shtetëror përkatës), si dhe trupave inspektuese palë të treta për inspektimin dhe vlerësimin e konformitetit të tyre duke përmirësuar kështu kuadrin ligjor dhe institucional.

Afati:

- Afati i procesit të konsultimit është deri më datën 22.11.2018, periudhë gjatë së cilës ju mund të konsultoni Projektligjin, Raportin e Vlerësimit të Ndikimit dhe Relacionin përkatës


dhe mbi këtë bazë mund të dërgoni rekomandimet dhe komentet Tuaja në adresën:
preng.prenga@infrastruktura.gov.al

Dokumentacioni:

- Projektligjin, Raportin e Vlerësimit të Ndikimit dhe relacionin përkatës i gjeni të publikuara në faqen elektronike të MIE në adresat e mëposhtme:

www.infrastruktura.gov.al dhe www.konsultimipublik.gov.al

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,



MINISTRI

Damian Gjoknuri